



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A

Datë ___/___/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale dhe pajisje elektrike, vegla, pajisje mekanike”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- MATERIALE ELEKTRIKE 31681410-0
- PJESE MEKANIKE 44316400-2

FONDI LIMIT:

- **99.954.000** (Nëntëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë) **Lekë , pa tvsh.**

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte

- **965.272,82** (Nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tetëdhjetë e dy) Euro pa TVSh

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 18.03.2024 – 18.03.2024 is 103.55

Argumentimi: Perllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit shtojca 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit*, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kërkesave pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për ta vërtetuar këtë kriter OE duhet të paraqes listepagesat e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Shënim: *Punonjesit do te kryejne transportin e mallrave, ngarkimin dhe shkarkimin e tyre deri ne ambientet e magazinave perkatese te Autoritetit Kontraktor, si dhe shpjegimet mbi perdormin e mallerave nese do te jete rasti.*

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e Cilësisë **ISO 9001-2015**, (e vlefshme), leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim, si dhe te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikata duhet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave që do te marre persiper sipas akt-marreshjes.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.4.2. Operatori Ekonomik per te kryer procesin e Furnizimit prane AK, duhet te disponoje minimumi nje mjet transporti ne pronesi ose me qera me peshe te lejuar jo me pak se 3500 kg. Per te vertetuar keto OE duhet te paraqese vertetim per pronesine ose Kontrate Qeraje, shoqeruar me Lejen e Qarkullimit dhe Lejen e Transportit, te leshuar nga Organet perkatese

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të

njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin nr.41 të LPP Pika 4/ç Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Si dhe Referuar listes se materialeve kerkuara ku një pjesë e tyre kane peshe specifike te lare dhe sasi te medha për transportin e tyre nevojitet mjet transporti me minimumin e kapacitetit të sipercituar. Per kete arsye grupi i hartimit te specifikimeve teknike kërkon që mjeti të ketë kapacitet mbajtës jo me pak se 3500 kg pasi do ishte e pamundur transporti i materialeve me peshe te larte .

2.4.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara ne seksionet **A, B, C, D, E, F** dhe **K**.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, Website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020” Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.4.4.Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë katalogun/et e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografite apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.4.5. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele, kërkesat e të cilat duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Emri, Adresa dhe website i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim, Emertimi i Katalogut të prodhuesit., Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut ne katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

2.4.6. Ofertuesi në ditën dhe orën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat pranë Autoritetit Kontraktor. Produktet për të cilat kërkohen të paraqiten mostrat janë të renditura sipas tabelës mëposhtë :

Artikulli	Përshkrimi i mallit	Njësia	Sasia
A	Materiale per Tension te Larte (Stacionet e pompimit dhe linjat)		
2	Shkarkues T.M 20 kV CE	Copë	1
3	Sigurese 20 kV 40 A CE ose 25A ose 16A	Copë	1
6	Sigurese 6 kV 100 A CE ose 40 A ose 25A ose 16A	Copë	1
10	Ndares 20kV 630 A CE	Copë	1
11	Terminal kablli 20kV 35-70 mm ² ose 95-150 mm ² ose 185-240 mm ²	Copë	1
14	Mufte kablli 20kV 1 set 3 cope	set	1
B	Materiale per ndricimin dhe rrjetin e shperndarjes		
16	Prozhektor LED 200W	Copë	1
17	Prozhektor LED 100 W	Copë	1
18	Prozhektor LED 50 W	Copë	1
19	Ndricues rrugor 100W IP65	Cope	1
20	Panel LED 60*60 36W	Copë	1

21	Panel LED 30*30 20W	Copë	1
22	Llampa LED 19-20 W, E27	Copë	1
23	Llampa LED 13-15W, E27	Copë	1
24	Llampa LED 10W , E27	Copë	1
29	Rele muzgu	Copë	1
30	Tub LED 6-8W 60cm	Copë	1
33	Izolant	Copë	1
41	Prize 3 fazore 32 A 0.4/1 kv, me 4 kunjja.	Copë	1
42	Spine 3 fazore 32 A 0.4/1 kv me 4 kunjja.	Copë	1
C	Materiale per panele te elektromotoreve		
49	Rele termike 2-6 A ose 6-8.5 A ose 7.5-11 A ose 36-52 A ose 45-63 A	Copë	1
54	Automat kabine 630A 4P ose 400 A 4P ose 250 A 4P ose 160 A 4P ose 100 A 4P	Copë	1
59	Leshues 750 A 3P ose 580 A 3P ose 265 A 3P 190 A 3P ose 140 A 3P ose 40 A 3P	Copë	1
65	Automat DIN35 100A 4P	Copë	1
66	Automat DIN35 63A 4P	Copë	1
67	Automat DIN35 40A 4P	Copë	1
70	Automat DIN35 63A 2P	Copë	1
71	Automat DIN35 40A 2P	Copë	1
75	Automat DIN35 16A 1P	Copë	1
78	Automat diferencial 63A 4P	Copë	1
82	Automat diferencial 40A 2P	Copë	1
85	Rele kohe 1-12 sek	Copë	1
D	Kabuj Fuqie		
91	Tel CU Ø1.5mm ose Ø2.5mm ose Ø4mm	ml	1
94	Tel CU Ø6mm ose Ø10mm ose Ø16mm	ml	1
97	Tel CU Ø25mm ose Ø35mm ose Ø50mm	ml	1
100	Kabell 3x1,5mm ² ose 3x2,5mm ² ose 4x2,5mm ² ose 4x4mm ²	ml	1
104	Kabell 4x6 mm ²	ml	1
105	Kabell 4x10 mm ²	ml	1
106	Kabell 4x16 mm ²	ml	1
107	Kabell 5x16mm ²	ml	1
108	Kabell 4x25 mm ²	ml	1
109	Kabell 3x35*1x25 mm ²	ml	1
110	Kabell 3x50*1x25 mm ²	ml	1
111	Kabell 3x70*1x35 mm ²	ml	1
112	Kabell 3x95*1x35 mm ²	ml	1
116	Kabell 1x120 ose 1x185 ose 1x240 mm ²	ml	1
119	Kabell komandimi 7x2.5 ose 12*2.5 ose 24x2.5	ml	1
E	Vegla pune dhe aparatura		

122	Tester izolacioni 1000V	cope	1
123	Mates i rezistences se tokezimit	cope	1
124	Kamer termike	cope	1
125	Multimeter dixhital 1000V	cope	1
126	Dare ampermetrike 600 A	cope	1
127	Tester elektrik 200A	cope	1
128	Dare per detektimin e rrjedhjes ne tokezim	cope	1
129	Seri Kriketosh	komplet	1
130	Seri kacavidash me izolacion deri 1000 V	komplet	1
131	Seri pincash me izolacion deri 1000 V	komplet	1
134	Cante per elektrikiste	Copë	1
F	Pajisje te vecanta dhe elektropompa		
176	Inverter 30kW per pompat e ujerave te zeza	Copë	1
181	Galexhant per ujera te zeza	Copë	1
H	Rroba pune		
188	ÇIZME PUNE DIELEKTRIKE	Palë	1
189	Doreza DIELEKTRIKE	Palë	1
K	Pajisje elektrike		
308	MATRAPIK 1.5 KW PER THYERJE BETONI	Copë	1
309	TRAPAN ME KORENT 1100 w	Copë	1
310	TRAPAN ME BATERI PROFESIONAL 18,0V , 1.3 AH ME DY BATERI	Copë	1
311	PAJISJE GUR FRESIBEL 115mm ME 2 BATERI,BATERI 20 VOLT 4AH	Copë	1
312	PAISJE GURI FLEKSIBEL (PER DISQE Ø = 230MM) PROFESIONAL	Copë	1
314	KOMPRESOR AJRI 200LT	Copë	1
315	VIDATOR ME BATERI PROFESIONAL	Copë	1
319	MOTOSHARE DORE	Copë	1
320	GJENERATOR TREFAZOR	Copë	1
321	GJENERATOR NJEFAZOR	Copë	1
322	MOTOPOMPE	Copë	1

Shënim: Kërkohet që OE në hapjen e ofertës të paraqes një produkt mostër duke u bazuar në rëndësinë që kanë këto produkte. Në tregun Shqipëtar dhe atë Botëror ekzistojnë disa tipe të ndryshme cilësish, fakt ky që na detyron për ti verifikuar paraprakisht produktet më të rëndësishme dhe për të qënë të sigurtë që ato do të jenë në cilësinë e duhur sipas specifikieve të kërkuara, që mirëmbajtja e rrjetit të SHRUKD-së të jetë në nivelin më të mirë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

A. Materiale per Tension te Larte (Stacionet e pompimit dhe linjat)

1. Transformator fuqie 20/0.4kV 2000kVA

Tipi i transformatorit:	Me Vaj, Hermetik
Instalimi:	Ambient i jashtern ose i brendshem
Fuqia nominale (ONAN):	2000kVA
Tensioni ne primar:	20000 V
Rregullimi i tensionit pa ngarkese:	±2x2.5% (5 pozicione)
Tensioni ne sekondar:	400V
Frekuenca:	50Hz
Grup lidhje:	Dyn5
Ftohja	SSH IEC EN 60076-2 ONAN
Materiali i peshtjellave:	Baker (Cu)
Izolatore:	Porcelan
Humbjet ne ngarkese	Jo me shume se 27000W
Humbjet pa ngarkese	Jo me shume se 3100W
Qendrueshmeria ndaj tensionit sipas IEC 60076-3	
- Qendrueshmeria ndaj frekuences	100Hz per 60sek
- Qendrueshmeria ndaj tensionit ne peshtjellen 20kV	40kV
- Qendrueshmeria ndaj tensionit ne peshtjellen 0.4kV	0.8kV

Qendrueshmeria elektrike e vajit te transformatorit
Rezistenca e izolacionit siper IEC 60076-1

70kV
 \geq TU/TL+kazan 9000 M Ω
 \geq TL/TU + kazan 12000 M Ω
 \geq TL dhe TU/kazan 10000 M Ω

2. Shkarkues T.M 20 kV CE

Materiali

Polimer

Rryma e shkarkimit

\geq 10kA

Tensioni maksimal i operimit

\geq 24kV

Tensioni maksimal i vazhdueshem i operimit

\geq 19.5kV

Tensioni i mbetur i impulsit te rrymes

Impulsi i shkarkimit te rrymes ne 1/4 μ s

\geq 80kV

Impulsi i shkarkimit te rrymes ne 8/20 μ s

\geq 70kV

Impulsi i nderrimit te rrymes 30/60 μ s


\geq 60kV

Qendrueshmeria e impulsit te rrymes per 2ms

\geq 250A

3-9. Siguresat TM

Tensioni nominal kV	Rryma nominale A	L/D (mm)	A/d (mm)
3.6/7.2	16	305/65	340/40
3.6/7.2	25	305/65	340/40
3.6/7.2	40	305/65	340/40
3.6/7.2	100	305/65	340/40
20-24	16	553/65	590/40
20-24	25	553/65	590/40
20-24	40	553/65	590/40



10. Ndares 20kV 630 A CE

Tensioni maksimal nominal kV	6-12
Rryma nominale A	630
Frekuenca nominale Hz	50
Shkalla e izolacionit te tensionit midis fazave kV	28

Shkalla e izolacionit te tensionit midis kontakteve te hapur kV	32
Distanca e shkarkimit mm	631
Rryma e lidhjes se shkurter ne 1sec kA	20-25
Rryma e lidhjes se shkurter ne 3sec kA	12.5-14
Rryma e lidhjes se shkurter ne pikun kA	50-62.5
Nr i ckycjeve mekanike	2000
Temperature e ambientit °C	-30 deri ne 40
Momenti kN	2

11. Terminal kablli 20kV 35-70 mm²

Terminalet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE te tensionit te mesem 20/24kV.

Seksioni i kabllit	35-70 mm ²
Tensioni nominal/maksimal	20/24kV
Shtrese armimi perforcuese	Po
Gjatesia totale e terminalit	400-500mm
Fustanellat kunder shiut	3 cope

12. Terminal kablli 20kV 95-150 mm²

Terminalet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE te tensionit te mesem 20/24kV.

Seksioni i kabllit	95-150mm ²
Tensioni nominal/maksimal	20/24kV
Shtrese armimi perforcuese	Po
Gjatesia totale e terminalit	400-500mm
Fustanellat kunder shiut	3 cope

13. Terminal kablli 20kV 185-240 mm²

Terminalet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE te tensionit te mesem 20/24kV.

Seksioni i kabllit	185-240 mm ²
Tensioni nominal/maksimal	20/24kV
Shtrese armimi perforcuese	Po
Gjatesia totale e terminalit	400-500mm
Fustanellat kunder shiut	3 cope

14. Mufte kablli 20kV 1 set 3 cope

Muftet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE te tensionit te mesem 20/24kV

Seksioni i kabllit	70-240mm ²
Tensioni nominal/maksimal	20/24kV
Gjatesia totale	440-480mm

15. Bllok kontaktesh per celesat 6kV

Bllok kontaktesh- Standarte

Pozicioni	Maksimumi numrave te bllokut te kontateve	Pershkrimi
Instalim paresor Nje pol	4 bllok : A9-A26 AE9-AE26 AL9-A126 5 bllok: A30,A40,AE30,AE40,AL30,AL40 6 bllok :A45 – AE110 AE45 – AE110 AF45 – AF110	1 N.O 1 N.C 1 N, O 1 N.C

B . Materiale per ndricimin dhe rrjetin e shperndarjes
16-18. Prozhektor LED 200W, LED 100 W, LED 50 W

Te dhena te pergjithshme

Fluksi i ndricimit: Deri ne 100 lm / W

Kendi I rrezeve : 95-105°

Lloji I mbrojtjes : IP65

Të dhënat elektrike

Pershkrimi i produktit	Menyra e operimit	Fuqia nominale	Tensioni nominal	Frekuenca	Faktori fuqise
Led 50W 3000 K	Paisjet elektronike te kontrollit	50W	220V	50Hz	>0.85
Led 100W 4000 K	Paisjet elektronike te kontrollit	100W	220V	50Hz	>0.85
Led 200W 4000 K	Paisjet elektronike te kontrollit	200W	220V	50Hz	>0.85

Te dhënat fotometrike

Temperatura e ngjyres	Fluksi I ndricimit	Ngjyra e drites	Indeksi I renditjes se ngjyrave	Devijimi standard i ngjyrave	Kendi I perhapjes se drites
3000 K	4900-5100 lm	E bardhe e ngrohte	> 75	≤5 sdc	95-105°
4000 K	>9000 lm	E bardhe e ftohte	> 75	≤5 sdc	95-105°
4000 K	>18000 lm	E bardhe e ftohte	> 75	≤5 sdc	95-105°

Jetegjatesia ne 25°C	Numri I cikleve	Tipi I lidhjes	Tipi I mbrojtjes	Standarti

Minimumi 50000 h	30000	Kabell ,3 pole	IP65	CE/CB/TÜV SÜD/EAC/RoHS ose ekuivalent sipas SSH
Minimumi 50000 h	30000	Kabell ,3 pole	IP65	CE/CB/TÜV SÜD/EAC/RoHS ose ekuivalent sipas SSH
Minimumi 50000 h	30000	Kabell ,3 pole	IP65	CE/CB/TÜV SÜD/EAC/RoHS ose ekuivalent sipas SSH

19. Ndricules rrugor 100W IP65

Ndriculesi duhet te jete IP68, me fluks ndricimi jo me pak se 90lm/W. Temperatura e ndricimit duhet te jete 4000-6500K. Ndriculesi duhet te jete LED, i pershtatshem per instalim ne krah shtylle me diameter 60-90mm.

20. Panel LED 60*60 36W

Panel katror me fluks te larte ndricimi, 600x 600mm

Te dhurat e pergjithshme

Fluksi i dritës: 4,320 lm
Efikasiteti i lartë ndricimi: deri në 120 lm / W
Jetëgjatësia: deri në 60,000 orë (në 25 ° C)
Materiali: Trupi alumin, difuzori polistiren

Te dhena elektrike

Fuqia nominale: 36W
Menyra e operimit: Me driver LED te jashtem
Tensioni nominal: 220...240V
Frekuencat e sistemit: 50/60Hz
Faktori i fuqise: >0.95

Te dhena fotometrike

Temperatura e ndricimit: 4000K
Fluksi i ndricimit: 4320lm
Eficensa e ndricimit: 120lm/W
Kendi i ndricimit: 120o
Dimensionet dhe pesha
Gjatesia: 595-600mm
Gjeresia: 595-600mm
Lartesia: 12.2-13mm
Pesha: 3250-3500g

21. Panel LED 30*30 20W

Karakteristikat e produktit

- Ndriculesi tavani me teknologji të avancuar LED
- I disponueshem ne forme katrore ose drejtkendore
- Temperatura e ngjyrës: 3000 K
- Veshje prej alumini, difuzor PMMA i ngrirë

Te dhënat elektrike	
Fuqia nominale	19-20W
Tensioni nominal ne hyrje	220...240V
Frekuenca e operimit	50/60Hz
Rryma nominale	84.000mA
Klasi i mbrojtjes	II
Menyra e operimit	Me tension rrjeti
Faktori i fuqisë	>0.90
Te dhënat fotometrike	
Fluksi luminoz	1500lm
Eficienca luminoze	80 lm/W
Temperatura e ngjyrës	3000K
Indeksi i ngjyrës Ra	80

Dimensionet dhe pesha	
Gjatesia	300.00 mm
Gjeresia	300 mm
Lartesia	62.00mm
Pesha e produktit	1500.00 g
Temperaturat dhe kushtet e operimit	
Temperatura e ambientit	-20...+40 °C
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Shkalla e mbrojtjes IK	IK03
Jetegjatesia	25000 ore
Numri i cikleve te ndezjes	15000

22. Llampa LED 19-20 W, E27

Fuqia:	19-20W
Tensioni nominal ne hyrje	220-240VAC, 50Hz
Fuqia ekuivalente e llampes konvencionale	150W
Rryma nominale	150-160mA
Fluksi i ndricimit	≥2400 lm
Eficienca e fluksit	≥129 lm/W
Temperatura e drites	E bardhe e ngrohte 2700K
Indeksi Ra	≥80
Kendi i ndricimit	≥150 grade
Gjatesia totale	120-130mm
Diametri	60-70mm
Pesha afersisht	70-80 gr
Jetegjatesia	≥15,000 ore
Numri i ndezjeve	≥100,000 here
Diapazoni i temperatures se punes	-15 deri ne +40°C

23. Llampa LED 13-15W, E27

Fuqia:	13-15W
Tensioni nominal ne hyrje	220-240VAC, 50Hz
Fuqia ekuivalente e llampes konvencionale	100W
Rryma nominale	100-110mA

Fluksi i ndricimit	≥1500lm
Eficienca e fluksit	≥117 lm/W
Temperatura e drites	E bardhe e ftohte 4000K
Indeksi Ra	≥80
Kendi i ndricimit	190-200 grade
Gjatesia totale	110-120mm
Diamteri	50-60mm
Pesha afersisht	40-50 gr
Jetegjatesia	≥15,000 ore
Numri i ndezjeve	≥100,000 here
Diapazoni i temperatures se punes	-20 deri ne +40°C

24. Lampa LED 10W , E27

Fuqia:	10W
Tensioni nominal ne hyrje	220-240VAC, 50Hz
Fuqia ekuivalente e llampes konvencionale	75W
Rryma nominale	50-60mA
Fluksi i ndricimit	≥1000lm
Eficienca e fluksit	≥117 lm/W
Temperatura e drites	E bardhe e ftohte 4000K
Indeksi Ra	≥80
Kendi i ndricimit	190-200 grade
Gjatesia totale	110-120mm
Diamteri	50-60mm
Pesha afersisht	30-40 gr
Jetegjatesia	≥15,000 ore
Numri i ndezjeve	≥100,000 here
Diapazoni i temperatures se punes	-20 deri ne +40°C

25. Priza shuko Universale, 250V

Prizat shuko te jene ne perputhje me standartet Gjermane dhe Italiane.

Prizat shuko 2P + E 16A te jene te pershtateshme per tensione nominale pune deri ne 250V.

Te dhenat tanklike.

Numri i poleve: 2P + Toke

Niveli i tensionit: 250V

Rryma: 16°

26. Spine shuko Universale, 250V

Spinat shuko te jene ne perputhje me standartet Gjermane dhe Italiane.

Spinat shuko 2P + E 16A te jene te pershtateshme per tensione nominale pune deri ne 250V.

Te dhenat tanklike.

Numri i poleve: 2P + Toke

Niveli i tensionit: 250V

Rryma: 16A

27. Lampa per ndricim te jashtem NAV/SON 250W, E40, 230V

Fuqia:	250w
Tensioni nominal i punes:	100 V
Tensioni i sistemit ne hyrje	220-240 VAC
Temperatura e ndricimit:	2000 K
Baza:	E 40

Fluksi nominal:	>32000 lm
Gjatesia e llambes:	250-262 mm
Diametri:	44-50 mm
Jetegjatesia:	36000 ore
Pesha:	Jo me shume se 175 gr

28. Llampa per ndricim te jashtem NAV/SON 150W, E40, 230V

Fuqia	150w
Tensioni nominal i punes	100 V
Tensioni i sistemit ne hyrje	220-240 VAC
Temperatura e ndricimit	2000 K
Baza	E 40
Fluksi nominal	>16000 lm
Gjatesia e llambes	204-212 mm
Diametri	44-50 mm
Jetegjatesia	>35000 ore
Pesha	Jo me shume se 150 gr

29. Rele muzgu

Releja e muzgut duhet te perbehet nga moduli i cili instalohet ne panelin e shtylles se ndricimit dhe nga sensori i cili instalohet ne ambient te hapur ne pjesen e sipërme te shtylles. Tensioni nominal i punes 220VAC. Fuqia e konsumuar 5W.

30. Tub led 6-8W 60cm

Te dhënat elektrike

Fuqia nominale	6-8W
Tensioni nominal ne hyrje	220...240V
Rryma nominale	35mA
Tipi i rrymës	AC
Frekuenca e operimit	50/60Hz
Faktori i fuqisë	>0.90

Te dhënat fotometrike

Fluksi luminoz	1800lm
Eficienca luminoze	121 lm/W
Temperatura e ngjyrës	6500K
Indeksi i ngjyrës Ra	≥80

Dimensionet dhe pesha

Gjatesia e pergjithshme	603.00 mm
Diametri i tubit	26.7mm
Pesha e produktit	100 g
Temperaturat dhe kushtet e operimit	
Temperatura e ambientit	-20...+45 °C

Jetegjatesia	30000 ore
Numri i cikleve te ndezjes	200000
Bazamenti	G13
Pa merkur	Po
Shkalla e mbrojtjes	IP20

31. Celes Bipolar 16A

Celes dy polar nje drejtimesh perdoren ne ato paisje ku kerkohet komplet nderprerja e lidhjeve elektrike me sistemin.

Numri i poleve 2
Rryma nominale 16 A
Tensioni i sistemit 250 V

32. Celes deviat

Numri i poleve 1
Rryma nominale 16 A
Tensioni i sistemit 250 V

33. Izolant

Izolant elektrik ne forme shiriti per izolimin e percjellesave te tensionit te ulet.

Rezistent kundrejt: Agjentëve atmosferikë, lagështisë, vajit, acideve, kimikateve korrozive
Temp: 0 °C - 80 °C
Forca elastike: 28 N/cm
Zgjatimi: 200%
Fortesia dielektrike: 700

Ngjyra	Trashësia	Lartësia	Gjatësia
E zezë	0.18mm	19mm	20m

34. Nastro gome kunder ujit

Izolant elektrik ne forme shiriti gome per izolimin e percjellesave te tensionit te ulet kundra ujit.

Rezistent kundrejt: Agjentëve atmosferikë, lagështisë, vajit, acideve, kimikateve korrozive
Temp: 0 °C - 80 °C
Forca elastike: 28 N/cm
Zgjatimi: 200%
Fortesia dielektrike: 700

Ngjyra	Trashësia	Lartësia	Gjatësia
E zezë	0.18mm	19mm	20m

35. Xhunto te termotkurrshme per pompa zhytесе 16-35mm² per kabell TU

Muftet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE me tension deri ne 1000V

Seksioni i kabllit 16-35mm²
Tensioni nominal/maksimal 1kV

36. Xhunto te termotkurrshme per pompa zhytесе 35-70mm² per kabell TU

Muftet duhet te jene te tipit te termotkurrshme ne nxehtesi per kablllo XLPE me tension deri ne 1000V

Seksioni i kabllit 35-70mm²
Tensioni nominal/maksimal 1kV

37. Tub korrogato fi25mm

Tub korrogato Φ 25
Temperaturat e punes -25 deri ne 40 °C.
Ngjyra E zeze
Trashesia e murit 0.8 mm minimum

38. Tub korrogato fi50mm

Tub korrogato Φ 50
Temperaturat e punes -25 deri ne 40 °C.

Ngjyra	E zeze
Trashesia e murit	0.8 mm minimum

39. Panel metalik shperndarje IP65 60*60*25

Dimensionet:	60*60*25
Klasa e mbrojtjes:	IP65
Numri i moduleve vertikale:	4
Numri i moduleve DIN:	25
Numri total i moduleve:	100

40. Kuti jashte murit 4M IP66

Dimensionet	
Gjeresia neto:	220mm
Lartesia neto:	170mm
Gjatesia neto:	220mm
Thellesia neto:	150mm

41. Prize 3 fazore 32 A 0.4/1 kv, me 4 kunjja.

Prizat industriale duhet te jene sipas standardit SSH EN 60309-1/2. Duhet te jene te ndertuara me materiale termoplastike rezistente ndaj zjarrit dhe me veteshuarje ne perputhje me standardin IEC 60695-2-11. Rezitenca ndaj goditjeve IK08. Duhet te jene me shkalle mbrojtje IP67. Siperfaqja nuk duhet te jete e lemuar per te mundesuar nje kapje me te sigurt. Duhet te jene me kapak i cili mund te hapet me nje dore ne saje te mekanizmit. Ne pjesen e hyrjes se kabllit duhet te jene me presokavo (shtrenguese) per te siguruar kapjen e kabllit. Duhet te jene te markuara me CE ne perputhje me direktivat europiane. Prizat duhet te jene me 5 percjellesa (3 faze + neuter + toke) Rryma nominale 32A, Tensioni nominal 400V. Frekuenca 50Hz

42. Spine 3 fazore 32 A 0.4/1 kv me 4 kunjja.

Spinat industriale duhet te jene sipas standardit SSH EN 60309-1/2. Duhet te jene te ndertuara me materiale termoplastike rezistente ndaj zjarrit dhe me veteshuarje ne perputhje me standardin IEC 60695-2-11. Rezitenca ndaj goditjeve IK09. Duhet te jene me shkalle mbrojtje IP67. Siperfaqja nuk duhet te jete e lemuar per te mundesuar nje kapje me te sigurt. Duhet te jene me kapak i cili mund te hapet me nje dore ne saje te mekanizmit. Ne pjesen e hyrjes se kabllit duhet te jene me presokavo (shtrenguese) per te siguruar kapjen e kabllit. Duhet te jene te markuara me CE ne perputhje me direktivat europiane. Spinat duhet te jene me 5 percjellesa (3 faze + neuter + toke) Rryma nominale 32A, Tensioni nominal 400V. Frekuenca 50Hz

43. Suporte per priza-celes 3 poste

Suport plastik per mbylljen e hapësirave boshe te kutive te shperndarjes. 3 modular.

44. Suporte per priza-celes 4 poste

Suport plastik per mbylljen e hapësirave boshe te kutive te shperndarjes. 4 modular.

45. Kuti per Celes-prize brenda murit 3 poste

Kuti plastike brenda murit 3 modulare per shperndarjen e prizave dhe celesave ne ambjente te brendshme

46. Kuti per Celes-prize brenda murit 4 poste

Kuti plastike brenda murit 4 modulare per shperndarjen e prizave dhe celesave ne ambjente te brendshme

47. Panel elektrik shperndarje 16M jashte murit

Panel elektrik plastic IP64 i pershtatshem per instalim jashte murit, me 16 module.

48. Panel elektrik shperndarje 32M jashte murit

Panel elektrik plastic IP64 i pershtatshem per instalim jashte murit, me 32 module.

C . Materiale per panele te elektromotoreve

49. Rele termike 2-6 A

Releja duhet te jete me veprim elektronik. Duhet te ushqehet nga leshuesi pra nuk duhet te kete nevoje per furnizim me energji shtese. Duhet te ofroje mbrojtje te shpejte per motorat ne rast mbingarkese apo difekti te fazes. Duhet te jete e perdorshme per elektromotorat standard dhe aplikimet e tyre te zakonshme. Duhet te kete saktesi te larte dhe diapazon te larte te operimit te temperatures dhe duhet te kete mundesine e zgjedhjes se menyres se shkycjes (10E,20E,30E). Duhet te kete kontakt te shkycjes NC, kontakt sinjali NO, menyre zgjedhje automatik/manual, funksionet stop dhe test dhe indicator te shkycjes. Keto rele duhet te lidhen direkt me leshuesat.

Diapazoni	2.0-6.3A.
Qarku ndihmes	deri ne 690VAC/DC 50Hz
Tensioni i qendrueshmerise impulsive U_{imp}	6kV
Numri i poleve	3
Rryma nominale e operimit AC	1.1A
Rryma nominale e operimit DC	0.5-1.5A
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Standardet	SSH EN 60947-1, SSH EN 60947-4-1, SSH EN 60947-5-1, UL 60947-1, UL 60947-4-1

50. Rele termike 6-8.5 A

Duhet te ofroje mbrojtje elektromekanike per qarkun kryesor. Duhet te ofroje mbrojtje te shpejte per motorat ne rast mbingarkese apo difekti te fazes. Duhet te jete e perdorshme per elektromotorat standard dhe aplikimet e tyre te zakonshme. Duhet te kete saktesi te larte dhe diapazon te larte te operimit te temperatures Duhet te kete kontakt te shkycjes NC, kontakt sinjali NO, menyre zgjedhje automatik/manual, funksionet stop dhe test dhe indicator te shkycjes. Keto rele duhet te lidhen direkt me leshuesat.

Diapazoni	6-8.5A
Qarku ndihmes	500VAC/440VDC
Qarku kryesor	690VAC/440VDC
Tensioni i qendrueshmerise impulsive U_{imp}	6kV
Tensioni i izolimit	690V
Numri i kontakteve ndihmese	1 No + 1NC
Numri i poleve	3 pole te mbrojtura
Rryma nominale e operimit AC	8.5A
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Standardet	SSH EN 60947-1, SSH EN 60947-4-1, SSH EN 60947-5-1, UL 60947-1, UL 60947-4-1

51. Rele termike 7.5-11 A

Duhet te ofroje mbrojtje elektromekanike per qarkun kryesor. Duhet te ofroje mbrojtje te shpejte per motorat ne rast mbingarkese apo difekti te fazes. Duhet te jete e perdorshme per elektromotorat standard dhe aplikimet e tyre te zakonshme. Duhet te kete saktesi te larte dhe diapazon te larte te operimit te temperatures Duhet te kete kontakt te shkycjes NC, kontakt sinjali NO, menyre zgjedhje automatik/manual, funksionet stop dhe test dhe indicator te shkycjes. Keto rele duhet te lidhen direkt me leshuesat.

Diapazoni	7.5-11A
Qarku ndihmes	500VAC/440VDC
Qarku kryesor	690VAC/440VDC
Tensioni i qendrueshmerise impulsive U_{imp}	6kV
Tensioni i izolimit	690V
Numri i kontakteve ndihmese	1 No + 1NC
Numri i poleve	3 pole te mbrojtura
Rryma nominale e operimit AC	11A
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Standardet	SSH EN 60947-1, SSH EN 60947-4-1, SSH EN 60947-5-1, UL 60947-1, UL 60947-4-1

52. Rele termike 36-52 A

Duhet te ofroje mbrojtje elektromekanike per qarkun kryesor. Duhet te ofroje mbrojtje te shpejte per motorat ne rast mbingarkese apo difekti te fazes. Duhet te jete e perdorshme per elektromotorat standard dhe aplikimet e tyre te zakonshme. Duhet te kete saktesi te larte dhe diapazon te larte te operimit te temperatures Duhet te kete kontakt te shkycjes NC, kontakt sinjali NO, menyre zgjedhje automatik/manual, funksionet stop dhe test dhe indicator te shkycjes. Keto rele duhet te lidhen direkt me leshuesat.

Diapazoni	36-52A
Qarku ndihmes	500VAC/440VDC
Qarku kryesor	690VAC/440VDC
Tensioni i qendrueshmerise impulsive U_{imp}	6kV
Tensioni i izolimit	690V
Numri i kontakteve ndihmese	1 No + 1NC
Numri i poleve	3 pole te mbrojtura
Rryma nominale e operimit AC	52A
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Standardet	SSH EN 60947-1, SSH EN 60947-4-1, SSH EN 60947-5-1, UL 60947-1, UL 60947-4-1

53. Rele termike 45-63 A

Duhet te ofroje mbrojtje elektromekanike per qarkun kryesor. Duhet te ofroje mbrojtje te shpejte per motorat ne rast mbingarkese apo difekti te fazes. Duhet te jete e perdorshme per elektromotorat standard dhe aplikimet e tyre te zakonshme. Duhet te kete saktesi te larte dhe diapazon te larte te operimit te temperatures Duhet te kete kontakt te shkycjes NC, kontakt sinjali NO, menyre zgjedhje automatik/manual, funksionet stop dhe test dhe indicator te shkycjes. Keto rele duhet te lidhen direkt me leshuesat.

Diapazoni	40-63A
Qarku ndihmes	500VAC/440VDC
Qarku kryesor	690VAC/440VDC
Tensioni i qendrueshmerise impulsive U_{imp}	6kV
Tensioni i izolimit	690V
Numri i kontakteve ndihmese	1 No + 1NC
Numri i poleve	3 pole te mbrojtura
Rryma nominale e operimit AC	63A
Shkalla e mbrojtjes	IP20
Standardet	SSH EN 60947-1, SSH EN 60947-4-1,

54. Automat kabine 630A 4P

Dimensionet

Gjeresia e produktit:	140 mm
Gjatesia e produktit:	205 mm
Thellesia e produktit:	103.5 mm
Pesha e produktit:	5.1 kg
Qendrueshmeria elektrike:	5000 cikle 60 cikle per ore
Qendrueshmeria mekanike:	20000 cikle 120 cikle per ore
Nr i poleve	3
Humbjet	41W per pole
Rryma nominale:	630 A
Tensioni nominal i qendrueshmerise impulsive:	8 kV
Tensioni nominal i izolimit:	1000 V
Tensioni nominal operacional:	690 V AC 750 V DC
Me rryme Ics	36 kA
Me rryme te lidhjes se shkurter Icu	36 kA

55. Automat kabine 400 A 4P

Automat me 4 pole per instalim ne kabine me terminale te perparme

Dimensionet 186*205*103mm

Pesha afersisht 6kg

Qendrueshmeria elektrike	7000 cikle/60 cikle ne ore
Qendrueshmeria mekanike	20000 cikle/ 120 cikle ne ore
Numri i poleve	4
Humbjet e fuqise	16.5W per pol max
Rryma nominale	400A
Qendrueshmeria e tensionit impulsiv	8kV
Tensioni i izolimit	1000V
Tensioni i operimit	690VAC
Kapaciteti shkyces ne lidhje te shkurter Ics	36kA
Tesnioni i testimit	3000V

56. Automat kabine 250 A 4P

Gjeresia e produktit:	105 mm
Gjatesia e produktit:	150 mm
Thellesia e produktit:	70 mm
Pesha e produktit:	1.6 kg
Informacion shtese	
Qendrueshmeria elektrike:	8000 cikle 120 cikle per ore
Qendrueshmeria mekanike:	25000 cikle 240 cikle per ore
Nr i poleve	3

Humbjet	17.8 W per pole
Rryma nominale:	250 A
